



Çfarë ndodh me depozitat e një banke në rast të transformimit të saj (bashkim, shkrirje, ndarje)?

Në rastet e transformimit të bankës së siguruar, nëpërmjet bashkimit, shkrirjes, ndarjes ose nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër, depozitat e siguruar në bankat pjesëmarrëse, mbeten të siguruar, për secilën bankë pjesëmarrëse në këtë proces, tre muaj prej datës që Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për përfundimin e procesit të transformimit.

Agjencia siguron depozitat në përputhje me dispozitat e këtij ligji edhe në rastin e likuidimit vullnetar të bankës së siguruar, të cilat mbeten të siguruar deri në përfundim të këtij procesi.

Në rast se një bankë e siguruar falimenton, kur fillon procesi i kompensimit dhe kush e bën atë?

Në rast se Banka e Shqipërisë shpall falimentimin dhe vendos bankën në likuidim, Agjencia kryen procesin e kompensimit, i cili fillon menjëherë pasi Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndërhyrjen.

Kur përfundon afati i procesit të kompensimit?

Ky proces përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të procesit të kompensimit.

Cilat janë mënyrat e kompensimit të depozitës së siguruar?

- a. Nëpërmjet transferimit të masës së kompensuar të depozitës në një bankë tjetër të siguruar me dëshirën e depozituesit.
- b. Nëpërmjet pagimit të shumës në lekë personit, sipas nivelit të kompensimit, përsëri sipas dëshirës së depozituesit.
- c. Nëpërmjet një banke agjente të siguruar.

Banka të siguruar



ProCredit Bank



Emporiki Bank



Veneto Banca



Credins Bank



Banka Kombëtare Tregtare



Alpha Bank



Intesa Sanpaolo Bank



Union Bank



Raiffeisen Bank



Banka Ndërkombëtare Tregtare



Banka e Bashkuar e Shqipërisë



Banka e Kreditit të Shqipërisë



NBG Bank



First Investment Bank



SOCIETE GENERALE GROUP



Agjencia e Sigurimit të Depozitave

DEPOZITUES!

Në çdo bankë që vendosni kursimet tuaja ka një siguri mbi sigurinë

ASD - Ne mbrojmë kursimet tuaja

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit (pallati pranë Ambasadës
Amerikane), Nr.317, Tiranë
Tel.: +355 4 2347298
www.dia.org.al



Cilat janë llojet e depozitave që sigurohen dhe kompensohen nga ASD?

Agjencia siguron dhe kompenson të gjitha llojet e produktit bankar depozitë në lekë dhe në valutë, të individëve rezidentë apo jo rezidentë në Shqipëri deri në 2.500.000 lekë, për çdo depozitor dhe në çdo bankë që operon në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Si llogaritet niveli i sigurimit dhe kompensimit të depozitës?

Ju vendosni të depozitoni në një bankë një depozitë me afat dymbëdhjetëmujor në masën 2.200.000 lekë, me interes 10 për qind në vit. Në rast se banka falimenton 6 muaj pas vendosjes së depozitës edhe interesi i fituar do të përfshihet në shumën e depozitës së siguruar e kompensuar, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelë 1. Llogaritja e depozitës së siguruar dhe masës së kompensimit.

LLOJI I DEPOZITËS	SHUMA E DEPOZITËS
Kursimi	2.200.000,00 lekë
Interesi i fituar në 6 muaj	108.493,10 lekë
Totali i depozitës që kompensohet	2.308.493,10 lekë

Ç'ndodh me pjesën e depozitës mbi 2.500.000 lekë?

Në rast se ju vendosni një depozitë kursimi në shumën 2.800.000 lekë, atëherë pjesa e depozitës e pasiguruar do të jetë sipas tabelës 2.

Tabelë 2 . Llogaritja e pjesës së pa siguruar të depozitës

LLOJI I DEPOZITËS	SHUMA E DEPOZITËS
Kursimi (a)	2.800.000,00 lekë
Pjesë e siguruar e depozitës (b)	2.500.000,00 lekë
Pjesa e pasiguruar e depozitës (c=a-b)	300.000,00 lekë

Nëse një depozitues do të vendosë disa depozita në emrin e tij në degë të ndryshme të së njëjtës bankë, a do të rritet niveli i kompensimit ?

Jo absolutisht, kompensimi bëhet deri në masën 2.500.000 lekë për çdo depozitues dhe jo për depozitë të ndara sipas llojit të depozitës.

Depozituesi mund të rrisë nivelin e kompensimit dhe të sigurimit duke i shpërndarë kursimet e tij, në depozita :

1. brenda të njëjtës bankë
 - i. në llogari të ndryshme në emër të pjestarëve të familjes
 - ii. në llogari të përbashkët me dy ose më shumë mbajtës
2. në banka të tjera të siguruar.

Çfarë është produkti “depozitë e përbashkët” ?

“Depozitë e përbashkët”, është llogaria bankare depozitë e vendosur në emër të dy a më shumë personave ose mbi të cilën dy ose më shumë persona kanë të drejtën e kryerjes së veprimeve kundrejt nënshkrimit.

Çfarë ndodh me depozitat e përbashkëta?

Si do të bëhet kompensimi në këtë rast?

Pjesa përkatëse e secilit prej depozituesve merret parasysh në llogaritjen e shumës së përgjithshme të depozitave që ka depozituesi në bankën e siguruar. Çdo depozitues prezumohet se zotëron pjesë të barabarta në depozitën e përbashkët përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e vendosjes së depozitës.

Psh. në një llogari me tre mbajtës, secili prej tyre është përfitues për efekt të kompensimit i 1/3-ës së shumës së depozitës, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në kushtin e vendosjes së depozitës.

Nëse keni një depozitë individuale dhe një depozitë të përbashkët, atëherë masa e kompensimit do të llogaritet përsëri deri në 2.500.000 lekë, mbi të dyja depozitat së bashku.

Pra, pavarësisht se në një bankë apo degë të ndryshme të së njëjtës bankë keni disa depozita, për efekt kompensimi ato mbledhen dhe llogariten si një llogari e vetme.

Si përcaktohet pronësia mbi depozitën në rast të kompensimit? Çfarë ndodh me depozitat e vendosura si garanci? Si do të bëhet kompensimi në këtë rast?

1. Në rastin e depozitave të vendosura si garanci për një person të tretë, të drejtat për kompensim të depozitës i njihen mbajtësit/mbajtësve të depozitës. Shuma e kompensimit për këtë depozitë nuk do t'i paguhet mbajtësit/mbajtësve të depozitës deri në çastin kur ai/ata është liruar nga detyrimi i garancisë. Në rast se mbajtësi/mbajtësit nuk arrin të lirohet nga detyrimi i garancisë, shuma e kompensimit përfitohet nga personi i tretë, në favor të të cilit është vendosur garancia.

2. Në rastin e depozitave të vendosura me kusht ose me afat në përfitim të personit të tretë, ky i fundit përfiton shumën e kompensimit me përfundimin e afatit ose me plotësimin e kushtit përkatës. Në të kundërt, shuma e kompensimit përfitohet nga mbajtësi/mbajtësit i depozitës ose trashëgimtarët e tij.

3. Në çdo rast kur ka një vendim gjyqësor për subjektin që përfiton kompensimin e depozitave të përmendura, Agjencia kryen kompensimin, në përputhje me këtë vendim gjyqësor.

Po në rast se depozituesi autorizon me prokurë një person të tretë të tërheqë vlera monetare në emër të tij?

Banka prezumon se përfituesi i depozitës, pra pronari i saj, është ai që paraqitet në dokumentacionin themelor të bankës së siguruar, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e prokurës.

Po në rastin e depozitave në valutë?

Këto depozita do të kompensohen deri në limitin e përcaktuar nga ligji, duke u konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e ndërhyrjes, që është dita e vënies së bankës në likuidim nga Banka e Shqipërisë.



Tabelë 3 . Llogaritja e shumës që kompensohet në depozitën e siguruar në valutë

LLOJI I DEPOZITËS	SHUMA E DEPOZITËS
Kursimi (a)	20.000 Eur
Kundra vlera në lekë (b=a*132)	2.640.000 lekë
Pjesë e depozitës që kompensohet (c)	2.500.000 lekë
Pjesa e depozitës që nuk kompensohet (b-c)	140.000 lekë

*132 EUR/Lek supozohet të jetë kursi i këmbimit të BSH-së në ditën e ndërhyrjes.

Në rast se vendosen në likuidim dy banka njëkohësisht dhe depozituesi ka vendosur kursimet e tij depozitë në të dyja bankat, si do të bëhet kompensimi ?

Në këtë rast, niveli i kompensimit për depozitat e siguruar do të llogaritet veçmas për secilën bankë. Pra, nëse jeni depozitues njëkohësisht në bankën X dhe Y që janë vënë në likuidim nga Banka e Shqipërisë, ju do të përfitoni nga procesi i kompensimit deri në shumën 2.500.000 lekë në secilën bankë.